



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-24-10118-1-2-1/C995
14 Nr. 1071/24
Dt. 11.12.2024

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi – Drejtor i ZPP-së** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**) dhe
2. **N.P.T. " Bajra ", Lidhja e Prizrenit, Prishtine emri i tregtar/ N.P.T. " Bajra ", emri biznesit, me seli në Prishtinë, me ARBK : 600312467, të cilën e përfaqëson z. Nehat Raifi, në tekstin e mëtejme: FURNIZUESI ,**

, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë: “Furnizimi me mjete dhe paisje zjarrfikëse, me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	4	10	11	8	1	2	1
Nr. i brendshëm	VU644	2	4	1	0	0	1	2	1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **Furnizimi me mjete dhe paisje zjarrfikëse nga Furnizuesi, ashtu sikurse është specifikuar ne Aneksin 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme pjesë e Dosjes së Tenderit.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon brenda afatit: jo më gjatë se 30 ditë pas datës së nënshkrimit të kontratës.

1.3 Vendi i dërgimit do të jetë : **NJPZ-Vushtrri**

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 19,600 €; [nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind/euro] Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesat do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pasi që Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i pranimit të mallit i Autoritetit Kontraktues të konfirmoi me shkrim pranim- Furnizimi me mjete dhe paisje zjarrfikëse, respektivisht pas dorëzimit të Raportit me shkrim se Furnizimi me mjete dhe paisje zjarrfikëse është dorëzuar – pranuar nga A.K. , si në aspektin teknik dhe në aspektin cilësor. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i pranimit të mallit do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit/Furnizuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për furnizimin dhe / ose shërbimin e përfunduar.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimit dhe / ose shërbimit është përgjegjësi e Furnizuesit ndërsa pajisa e dorëzuar duhet, në të gjitha aspektet, ti plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni për cilësinë e mallit do të mbetet përgjegjësi e furnizuesit.

Garancioni i kualiteti të mallit për Furnizimi me mjete dhe paisje zjarrfikëse është 12 muaj nga data e dorëzimit paisjeve.

Dokumenti - deklaratë garantuese me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur, me të cilën furnizuesi siguron me vlerën e përgjithshme të kontratës për periudhën kohore prej: për Furnizimi me mjete dhe paisje zjarrfikëse dhe 12 muaj nga data e dorëzimit të mallit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimit dhe / ose shërbimit të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9

Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10

Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11

Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12

Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14

Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;


- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik:
N.P.T. " Bajra ", - Prishtinë

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë

Emri:	Nehat Raifi	Emri:	Ilmi Azemi
Pozita:	Drejtor ekzekutiv	Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	11.12.2024	Data:	11.12.2024
Vula:		Vula:	